Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.04-60/01-1727/22
Kaçanik: 28.01.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 janar 2022, pos tjerash,

**NJOFTOHET**

1. Me Aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit - Për përfundimin e Periudhës së Parë të vitit shkollor 2021/2022, në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën për përfundimin e Periudhës së Parë të vitit shkollor 2021/2022, të hartuar nga Drejtoria e Arsimit.

2. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejmë: "Informatë për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit Shkollor 2020/2021", i përmbledhur në gjithsej : 19 faqe / Lënda: 01Nr. 04 Nr. 60/01-1727/22.

**Më këtë Shkresë njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

KAÇANIKU

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit
04.Nr. 610/01-1727/22
Kaçanik

# I N F O R M A T Ë

**Për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2021-2022**

Kaçanik, Janar 2022

## Përmbajtja:


1. Hyrje
2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor
3. Investimet në infrastrukturën shkollore dhe pajisje tjera
4. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
    - 5.1. Rrjeti shkollor
    - 5.2. Suksesi i nxënësve – Arsimi fillor
6. Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
    - 5.1. Nxënësit dhe suksesi i tyre në dy nivelet 1 dhe 2
7. Kuadri arsimor
8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AML X – XII)
    - 8.1. Numri i nxënësve
    - 8.2. Suksesi i nxënësve
9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve


**Shkurtesat:**

- DA- Drejtoria e Arsimit
- MASHTI- Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
- PF- Parafillor ose niveli 0

- AF- Arsimi Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU- Arsimi i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML- Arsimi i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF- Arsimi Joformal

## 1. Hyrje

Informata për përfundimin e Periudhës së Parë ka për qëllim të njoftoj institucionet komunale dhe publikun e gjërë mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut për vitin shkollor 2021-2022. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit shkollor, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë dhe suksesin e arritur gjatë kësaj periudhe mësimore.
Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesi i arritur e të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezantuara mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, e që zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, Mesëm të Ulët dhe Mesëm të Lartë).

Viti i ri shkollor 2021 – 2022, sipas kalendarit shkollor është dashtë të fillon më 1 shtator 2021, ndërsa për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19, është shtyrë deri më 27 shtator 2021 kur nisin mësimet në vitin e ri shkollor. Viti i ri shkollor ka filluar mbarë në të gjitha institucionet arsimore, sipas skenarit A, në gjithsej 23 shkolla fillore e të mesme të ulëta (12 shkolla amë me paralelet e ndara), 2 shkollat e mesme të larta dhe 1 Qerdhe për fëmijë.

Që nga fillimi i muajit tetor 2021, shkollat e Komunës së Kaçanikut kanë filluar të funksionojnë sipas skenarit RIKTHIM me përjashtim të ShFMU "Emin Duraku" të qytetit e cila ka vazhduar sipas skenarit C. Në klasat ku janë identifikuar nxënës të infektuar me virusin COVID-19, klasat janë ndarë në dy grupe ku njëri grup ka vijuar me prani fizike në shkollë e grupi tjetër për një javë janë angazhuar online.
Në ndërkohë sipas një Njoftim të MAShTI për fillimin e zbatimit të Vendimit për zgjatjen e orës mësimore në 45 minuta, të gjitha institucionet arsimore kanë filluar të zbatohet atë që nga 17 nëntori 2021.

Periudha e parë ka përfunduar më 30 dhjetor, ndërsa ishte planifikuar të përfundonte më 24 dhjetor, sipas Vendimit për kompensimin e ditëve të humbura (në fillim të vitit mësimor) për shkak të pandemisë COVID-19. Gjatë muajit tetor e nëntor janë zëvendësuara nga dy ditë të humbura (të shtunave) e në dhjetor po ashtu, ditët e humbura janë zëvendësuar me dy të shtune dhe më 28, 29 dhe 30 dhjetor.

## 2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

Drejtoria e Arsimit (DA), edhe pse në kushte dhe rrethana jo të zakonshme, me kohë ka nisë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022, duke i respektuar në tërësi udhëzimet dhe vendimet e MASHTI-t e IKShPK-së për fillimin e mësimit në kushte pandemie.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 512 fëmijë parafillor prej tyre 493 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 19 fëmijë të tjerë janë sistemuar në QEAP "Agimi", ndërkaq janë regjistruar gjithsej 456 fatos në klasat e para. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Në Gjimnazin "Skënderbeu" sivjet janë regjistruar 238 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 288 nxënës të ndarë në 9 paralele (4 në drejtimin Shkenca Natyrore me 111 nxënës dhe 5 në drejtimin Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, me 127 nxënës), e ndërkaq në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 142 nxënës në 10 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 288 nxënës me 10 paralele të ndarë në 4 Drejtimet: 1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrikë me nga 1 paralele, 2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet dhe Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele 3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes klimatizimit ujësjellësit e kanalizimit me 2 paralele dhe Trafik rrugor e Automekanik me nga 1 paralele dhe 4. Juridik me profilin; Asistent Juridik me 1 paralele.

Sa i përket kuadrit arsimor, DA gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit..
Janë bërë përpjekje edhe për përgatitjet higjienike e teknike dhe kryesisht të gjitha shkollat kanë qenë të përgatitura në këtë aspekt për fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022.

## 3. Investimet në infrastrukturën shkollore dhe pajisje tjera

Para fillimit të vitit shkollor janë kryer shumë renovime në objektet shkollore, ndërkaq është duke vazhduar ndërtimi i objektit të ri shkollor në fshatin Doganaj e po ashtu, janë duke u ndërtuar edhe Palestra sportive në ShMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik dhe në ShFMU "7 Shtatori" në Begracë.

**Projektet e realizuara nga Buxheti komunal në vlerën e përgjithshme prej 120,000 euro**

Në ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik në objektin e vjetër është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme dhe rregullimi i dyshemesë së sallës së arsimtarëve, në vlerë 2000 euro, ndërsa në në objektin e Lagjes Dushkaja është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 18 dyerve dhe rregullimi i një pjesë të kulmit në vlerë 11,600 euro.
Në ShFMU "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër – paralelja në Fushë të Pajtimi, është ndërtuar aneksi i dedikuar per toalete në vlerë 25 mijë euro.
Në ShFMU "7 Shtatori" në Begracë është bërë renovimi i toaleteve, montimi i 3 dyerve të reja dhe rregullimi i sistemit të ngrohjes, në vlerë 3,758 euro.
Në ShFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 11 dyerve dhe punimi i shkallëve për katin e II, në vlerë 6,750 euro, ndërsa në paralelen e ndarë në Nikaj është bërë ngjyrosja e një pjese të murit të brendshëm dhe renovime tjera të imta në vlerë 1700 euro.
Në ShFMU "Kadri Zeka" në Dubravë është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 20 dyerve, ndërsa në shkolën e fshatit Vatë është ndërtuar fusha sportive në vlerën e përgjithshme prej 15,500 euro.
Në ShFMU "Idriz Seferi" - Paralelja e ndarë fizike në Gajre është ndërtuar aneksi i dedikuar per toalete dhe rregullimi i rrethojës në vlerë 20,600 euro.
Në Shkollën "Dituria" në Ivajë është bërë shtruarja e oborrit të shkollës me kubëza betoni në vlerë 3,100 euro, ndërsa në Paralelen e ndarë në Strazhë eshtë ndërtuar fusha sportive në vlërë afër 7 mijë euro (6,893 euro).
Në ShFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, ndërrimi i 14 dyerve dhe rregullimi i dyshemese me linoleum, në vlerë 6,100 euro, ndërsa në paralelen e Bajnicës janë renovuar toaletet, janë ndërruar 13 dyer dhe është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme në vlerë 6000 euro.
Në ShMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik ka filluar me vonesë ndërtimi i rrethojës së oborrit në në vlerë 6.000 euro, ndërsa në Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik, në oborrin e shkollës është bërë veshja e shkallëve të jashtme me pllaka në vlerë 1.700 euro.

Në ndërkohë disa nga shkollat janë pajisur me inventar shkollor si banka, karrika për nxënës, karrika për mësimdhënës (për sallë të arsimtarëve), sirtarë, vitrina, tavolina për mësimdhënës në klasa, kompjuter, perde, tepihë për klasa parafillore dhe tabela shkollore, ndërkaq në Gjimnazi "Skënderbeu" është furnizuar Kabineti i biologjisë me mjete e pajisje tjera. Po ashtu, në Shkollën profesionale janë pajisur me materiale punëtoritë shkollore: ai i elektrikës, nxehjes, metal punues dhe ujësjellësit, e në Qerdhën e fëmijëve është kompletuar kuzhina si dhe janë vendosur televizorë në klasa e pajisje tjera.

## 4. Ngritja e cilësisë - Zbatimi i Kurrikulës së re

Pjesë e përgatitjeve për vitin e ri shkollor kanë qenë edhe trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Para fillimit të vitit shkollor, në muajin korrik, për gjashtë ditë rresht, janë trajnuar 27 mësimdhënës të nivelit parafillor e fillor. DA vazhdimisht identifikon nevojat e mwsimdhwnwsve pwr trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku pwrmes sw tyre synohet aplikimi i shkathtwsive tw reja, por edhe zhvillimit e ngritjes profesionale. DKA, fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritje të cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre ne vend e më gjërë.

DA edhe gjatë këtij viti shkollor, ka bërë përpjejkje për furnizimin me kohë të shkollave me materiale pedagogjike e materiale tjera të nevojshme, ndërkaq që me kohë janë shpërndarë edhe librat për nxënës të cilat edhe për këtë vit shkollor, qeveria e vendit, përmes MASHTI-it dhe shtëpive botuese të kontraktuara, i kanë furnizuar falas nxënësit për klasat 1 – V dhe VII e VIII, ndërsa jo edhe për nivelin parafillor dhe klasat VI, e IX.

Drejtoria e Arsimit, duke qenë kompetente për zhvillimin e arsimit synon të ndërtojë një shoqëri të arsimuar e të dijës, një sistem arsimor cilësor i krahasueshëm me arsimin e vendeve të zhvilluara. Ngritja e cilësisë mbetet prioritet bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve por edhe ngritjen e përpjekjeve dhe përgjegjësisë në punë.
Tani më janë trajnuar po thuajse të gjithë mësimdhënësit që nga viti 2017, e këndej të cilët kanë vijuar trajnimet për zbatimin e Kornizës Kurrikulare në Kosovë dhe të njejtit janë në zbatim të këtij programi të ri shkollor.
Përmes zbatimit të Kornizës Kurrikulare të Kosovës synojmë të arrijmë:

- Gjithëpërfshirjen - përfshirja e të gjithë fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor
- Zbatimin e kompetencave
- Mësimdhënia dhe nxënia e integruar dhe koherente
- Autonomia dhe fleksibilitet në nivel shkolle

- Përgjegjësia dhe llogaridhënia
- Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve,
- Sigurimi i mjedisit të pastër dhe favorshëm në shkollë etj.

## 5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe nxënie.
Edhe gjatë kësaj periudhe të këtij viti shkollor, rëndësi e veçant i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësive, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi.
Arsimit parashkollor (nivelit 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçant. Në të gjitha shkollat amë funksionojnë paralelet parafillore, me përjashtim të asaj në Kotlinë. Në vitin shkollor 2018-2019 pati filluar edhe në këtë shkollë paralelja parafillore por në ndërkohë në mungesë të fëmijëve, pushoi së funksionuari.

Në nivelin 0 (parafillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 512 fëmijë prej tyre 493 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 19 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP "Agimi", ndërkaq që edhe sivjet në grupin e fëmijëve parafillor nuk është paraqit asnjë në shkollën e Kotlinës. Vlen të theksohet se edhe sivjet është duke u zbatuar Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parafillore, që do të thotë se fëmijët e një paralele janë ndarë në dy grupe (një edukatore punon me dy grupe).

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Përmes zhvillimit të arsimit bazë, Komuna e Kaçanikut synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë në Komunë e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkolla të mesme. Përmes këtij niveli të arsimit, ne synojmë zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Politikat tona zhvillimore janë të orientuara në përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënës që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, fokus i yni është përfshirja e numrit sa më të

madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" e po ashtu edhe në Gjimnazin "Skënderbeu".

### 5.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 12 shkolla amë dhe 11 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë, Runjevë dhe Kërbliq,
2. SHFMU "Idriz Seferi" në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec me paralelen e ndarë në Nikaj
4. SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFMU "Ali Asllani" në Doganaj
6. SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj me paralelen e ndarë në Bajnicë
7. SHFMU "Qamil Ilazi" me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtimit
8. SHFMU "7 Shtatori" në Begracë
9. SHFMU "Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFMU " Gafurr Luma" në Glloboçicë
11. SHFMU "Dituria" në Ivajë me paralelen e ndarë në Shtrazë dhe
12. SHFMU "Naim Frashëri" në Kotlinë

Përveç shkollave fillore në Komunën tonë funksionojnë edhej 2 shkolla të mesme: Gjimnazi "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik dhe një çerdhe për fëmijë, QEAP "Agimi" në Kaçanik.
Bazuar në kushtet dhe mundësitë mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AMU dhe AML është i kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor. Në Komunën tonë gjatë Periudhës së Parë të këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 23 shkolla të nivelit fillor, të plota dhe jo të plota.

### 5.2 Suksesi i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2316 nxënës sa ishin regjistruar në fillim të Periudhës së Parë, kanë vijuar gjithsej 2292 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 2270 nxënës, apo shprehur në përqindje 99.04 %. Me sukses negativ kanë ngelur 22 nxënës e 24 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor, gjithsej 2316 me 2430, sa ishin regjistruar një vit më parë (2020/21), atëherë del se në këtë vit shkollor, 2021-2022, në këtë nivel, janë regjistruar gjithsej 114 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 3.8.

**Për më shumë të dhëna të nivelit I-V, shih Tabelën Nr. 1**

Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2021 – 2022

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxënës | | Vijojnë | | Shkëlq. | | Sh.mirë | | Mirë | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojnë | | Të çregjis | | Nota mesatare |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 451 | 198 | 447 | 197 | 263 | 122 | 114 | 47 | 58 | 23 | 12 | 5 | 447 | 197 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 2 | 0 | 4.39 |
| II | 458 | 227 | 452 | 226 | 260 | 145 | 92 | 44 | 65 | 24 | 35 | 13 | 452 | 226 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 1 | 4.20 |
| III | 457 | 196 | 454 | 195 | 252 | 121 | 100 | 43 | 71 | 21 | 26 | 8 | 449 | 193 | 98.89 | 5 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 0 | 0 | 3 | 1 | 4.19 |
| IV | 486 | 229 | 481 | 228 | 236 | 145 | 118 | 52 | 80 | 22 | 34 | 6 | 468 | 225 | 97.29 | 4 | 1 | 5 | 0 | 4 | 2 | 13 | 3 | 0 | 0 | 5 | 1 | 4.01 |
| V | 464 | 227 | 458 | 226 | 208 | 129 | 102 | 51 | 109 | 40 | 35 | 6 | 454 | 226 | 99.12 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 6 | 1 | 3.96 |
| I-V | 2316 | 1077 | 2292 | 1072 | 1219 | 662 | 526 | 237 | 383 | 151 | 142 | 38 | 2270 | 1067 | 99.04 | 11 | 3 | 6 | 0 | 5 | 2 | 22 | 5 | 2 | 1 | 22 | 4 | 3.8 |

## 6. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2021-2022 ishte 1896, prej tyre 900 femra, ndërsa nëse e krahasojmë me një vit më parë (gjatë vitit shkollor 2020-2021 ky numri i nxënësve ishte 1910), del se në këtë vit shkollor, në nivelin e mesëm të ulët, janë gjithsej 14 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1896 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar 1870 dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsejt 1373 nxënës apo shprehur në përqindje 73.42 %, ndërkaq me nota negative kanë ngelur gjithsej 497 e 26 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.56.

**Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2**

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2021 – 2022

| | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gj.nxënës | | Vijojnë | | Shkëlq. | | Sh.mirë | | Mirë | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojn | | Të çregjis | | Nota mesatare |
| Klasa | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| VI | 492 | 227 | 489 | 226 | 166 | 102 | 130 | 69 | 102 | 38 | 21 | 7 | 419 | 216 | 85.68 | 30 | 5 | 20 | 4 | 20 | 1 | 70 | 10 | 1 | 0 | 2 | 1 | 3.69 |
| VII | 455 | 212 | 445 | 212 | 118 | 76 | 94 | 49 | 93 | 42 | 20 | 8 | 325 | 175 | 73.03 | 44.00 | 19 | 27 | 11 | 49 | 7 | 120 | 37 | 4 | 0 | 6 | 0 | 3.52 |
| VIII | 485 | 240 | 479 | 238 | 140 | 102 | 99 | 66 | 87 | 38 | 12 | 4 | 338 | 210 | 70.56 | 36.00 | 16 | 38 | 7 | 67 | 5 | 141 | 28 | 2 | 1 | 4 | 1 | 3.61 |
| IX | 464 | 221 | 457 | 219 | 117 | 90 | 93 | 59 | 70 | 33 | 11 | 0 | 291 | 182 | 63.67 | 42 | 16 | 29 | 4 | 95 | 17 | 166 | 37 | 4 | 2 | 3 | 0 | 3.43 |
| VI-IX | 1896 | 900 | 1870 | 895 | 541 | 370 | 416 | 243 | 353 | 151 | 64 | 19 | 1373 | 783 | 73.42 | 73.42 | 56 | 114 | 26 | 227 | 27 | 497 | 112 | 11 | 3 | 15 | 2 | 3.56 |

## 6.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI –IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2021-2022 ka qenë 4212 (1977 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 4162, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3643 apo 87.49 %. Ndërkaq, me nota negative kanë mbetur 519 nxënës prej tyre 117 femra e 50 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.84. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2021-2022 (4212) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë (4340) del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësvë të regjistruar është më i vogël për 128 nxënës.

**Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3**

Suksesi sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

| | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxënës | | Vijojnë | | Shkëlq. | | Sh.mirë | | Mirë | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojn | | Të çregjis | | Nota mesatare |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 451 | 198 | 447 | 197 | 263 | 122 | 114 | 47 | 58 | 23 | 12 | 5 | 447 | 197 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 2 | 0 | 4.39 |
| II | 458 | 227 | 452 | 226 | 260 | 145 | 92 | 44 | 65 | 24 | 35 | 13 | 452 | 226 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 1 | 4.20 |
| III | 457 | 196 | 454 | 195 | 252 | 121 | 100 | 43 | 71 | 21 | 26 | 8 | 449 | 193 | 98.89 | 5 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 0 | 0 | 3 | 1 | 4.19 |
| IV | 486 | 229 | 481 | 228 | 236 | 145 | 118 | 52 | 80 | 22 | 34 | 6 | 468 | 225 | 97.29 | 4 | 1 | 5 | 0 | 4 | 2 | 13 | 3 | 0 | 0 | 5 | 1 | 4.01 |
| V | 464 | 227 | 458 | 226 | 208 | 129 | 102 | 51 | 109 | 40 | 35 | 6 | 454 | 226 | 99.12 | 2 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 6 | 1 | 3.96 |
| I-V | 2316 | 1077 | 2292 | 1072 | 1219 | 662 | 526 | 237 | 383 | 151 | 142 | 38 | 2270 | 1067 | 99.04 | 11 | 3 | 6 | 0 | 5 | 2 | 22 | 5 | 2 | 1 | 22 | 4 | 3.8 |
| VI | 492 | 227 | 489 | 226 | 166 | 102 | 130 | 69 | 102 | 38 | 21 | 7 | 419 | 216 | 85.68 | 30 | 5 | 20 | 4 | 20 | 1 | 70 | 10 | 1 | 0 | 2 | 1 | 3.69 |
| VII | 455 | 212 | 445 | 212 | 118 | 76 | 94 | 49 | 93 | 42 | 20 | 8 | 325 | 175 | 73.03 | 44 | 19 | 27 | 11 | 49 | 7 | 120 | 37 | 4 | 0 | 6 | 0 | 3.52 |
| VIII | 485 | 240 | 479 | 238 | 140 | 102 | 99 | 66 | 87 | 38 | 12 | 4 | 338 | 210 | 70.56 | 36 | 16 | 38 | 7 | 67 | 5 | 141 | 28 | 2 | 1 | 4 | 1 | 3.61 |
| IX | 464 | 221 | 457 | 219 | 117 | 90 | 93 | 59 | 70 | 33 | 11 | 0 | 291 | 182 | 63.67 | 42 | 16 | 29 | 4 | 95 | 17 | 166 | 37 | 4 | 2 | 3 | 0 | 3.43 |
| VI-IX | 1896 | 900 | 1870 | 895 | 541 | 370 | 416 | 243 | 353 | 151 | 64 | 19 | 1373 | 783 | 73.42 | 151 | 56 | 114 | 26 | 227 | 27 | 497 | 112 | 11 | 3 | 15 | 2 | 3.56 |
| I-IX | 4212 | 1977 | 4162 | 1969 | 1762 | 1035 | 940 | 479 | 734 | 302 | 209 | 56 | 3643 | 1850 | 87.49 | 160 | 59 | 120 | 26 | 232 | 30 | 519 | 117 | 13 | 4 | 37 | 6 | 3.84 |

**Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4**

| Nr. | shk oll. | Gjithsej nxënës | | Vijojnë | | SUKSESI POZITIV: Shkëlq | | Shumë mirë | | Mirë | | Mjaft. | | Gjithsej pozitiv | | % | SUKSESI NEGATIV: 1x1 | | 2x1 | | 3x1 | | Gj negativ | | Të Panotuar: Nuk vijojnë | | Çregjistruar | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | Gj | F | % | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj. | F | Gj | F | |
| 1 | "E.D" | 1359 | 625 | 1349 | 622 | 574 | 332 | 290 | 151 | 220 | 82 | 44 | 8 | 1128 | 573 | 83.62 | 65 | 26 | 49 | 10 | 107 | 13 | 221 | 49 | 5 | 2 | 5 | 0 | 3.82 |
| 2 | "K.Z" | 417 | 189 | 400 | 184 | 150 | 89 | 90 | 56 | 83 | 27 | 14 | 3 | 337 | 175 | 84 | 17 | 6 | 20 | 2 | 26 | 2 | 63 | 9 | 2 | 1 | 15 | 4 | 3.63 |
| 3 | "I.S" | 465 | 238 | 465 | 238 | 219 | 133 | 115 | 63 | 87 | 35 | 22 | 3 | 443 | 234 | 95 | 11 | 4 | 5 | 0 | 6 | 0 | 22 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.03 |
| 4 | "J.G" | 279 | 138 | 275 | 138 | 126 | 82 | 68 | 31 | 46 | 16 | 19 | 5 | 259 | 135 | 94 | 3 | 0 | 4 | 2 | 9 | 1 | 16 | 3 | 2 | 0 | 2 | 0 | 3.97 |
| 5 | "N.O. | 293 | 133 | 293 | 133 | 120 | 67 | 52 | 27 | 65 | 28 | 13 | 4 | 250 | 126 | 85 | 18 | 3 | 10 | 2 | 15 | 2 | 43 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.64 |
| 6 | "Q.I." | 394 | 181 | 393 | 181 | 168 | 90 | 90 | 42 | 75 | 51 | 12 | 2 | 344 | 164 | 88 | 20 | 10 | 15 | 6 | 14 | 1 | 49 | 17 | 1 | 0 | 0 | 0 | 3.96 |
| 7 | "A.A" | 319 | 141 | 317 | 141 | 136 | 78 | 67 | 27 | 43 | 20 | 24 | 5 | 270 | 130 | 85 | 12 | 4 | 7 | 1 | 28 | 6 | 47 | 11 | 1 | 0 | 1 | 0 | 3.81 |
| 8 | "7.Sh | 269 | 137 | 269 | 137 | 124 | 72 | 49 | 26 | 32 | 14 | 18 | 11 | 223 | 123 | 83 | 14 | 6 | 9 | 3 | 23 | 5 | 46 | 14 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.67 |
| 9 | "G.L. | 141 | 69 | 135 | 67 | 50 | 30 | 33 | 16 | 29 | 13 | 19 | 7 | 131 | 66 | 97 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 1 | 0 | 0 | 6 | 2 | 3.67 |
| 10 | "A.B. | 166 | 75 | 165 | 75 | 56 | 34 | 59 | 23 | 37 | 13 | 8 | 3 | 160 | 73 | 97 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 3.85 |
| 11 | "Ditu | 89 | 41 | 83 | 41 | 29 | 19 | 22 | 14 | 14 | 3 | 16 | 5 | 81 | 41 | 96 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 6 | 0 | 3.77 |
| 12 | "N.F" | 24 | 12 | 21 | 12 | 10 | 9 | 5 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 18 | 12 | 86 | 0 | 0 | 1 | 0 | 2 | 0 | 3 | 0 | 1 | 1 | 2 | 0 | 4.42 |
| | Gjith | 4212 | 1977 | 4165 | 1969 | 1762 | 1035 | 940 | 479 | 734 | 302 | 209 | 56 | 3643 | 1850 | 87 | 160 | 59 | 120 | 26 | 232 | 30 | 519 | 117 | 13 | 4 | 37 | 6 | 3.84 |

## 7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmërija e rregullt e arsimitarëve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimit ndikon nëgativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I – IX), në këtë Periudhë mësimore janë angazhuar gjithsej 356 arsimtarë (173 femra) prej tyre 149 në mësimin klasor dhe 207 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 355 apo shprehur në përqindje 99.71 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përgjatë kësaj periudhe, kanë bërë gjithsejt 51,691 mungesa prej tyre 40,612 të arsyeshme, ose 12.26 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë kësaj Periudhe kanë humbur 905 orë mësimore ose mesatarisht nga 2.54 orë për arsimtarë.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5**

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

| Nr. | Emri I shkolles | KUADRI ARSIMOR | | | | | | | | | | | | mungesat e nxënësve | | Mesat. për | Orët e pa mbajtura të | Mesatarja për |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mësimi klasor | | | | Mësimi lëndor | | | | Dy ciklet | | | | | | | | |
| | | Gj | F | Kv | % | Gj | F | Kv | % | GJ | F | Kv | % | GJ | ARS. | nx. | mësimdh | mësimdh |
| 1 | "Emin Duraku" | 40 | 37 | 40 | 100 | 40 | 17 | 40 | 100 | 80 | 54 | 80 | 100 | 20288 | 16805 | 14.92 | 199 | 2.40 |
| 2 | "Idriz Seferi" | 17 | 9 | 17 | 100 | 22 | 11 | 22 | 100 | 39 | 20 | 39 | 100 | 4284 | 3710 | 9.21 | 136 | 3.48 |
| 3 | "Kadri Zeka" | 19 | 9 | 19 | 100 | 16 | 6 | 16 | 100 | 35 | 15 | 36 | 100 | 6830 | 4770 | 16.37 | 118 | 3.37 |
| 4 | "Jusuf Gërvalla" | 12 | 9 | 12 | 100 | 17 | 7 | 17 | 100 | 29 | 16 | 29 | 100 | 3135 | 2715 | 9.88 | 53 | 1.82 |
| 5 | "Qamil Ilazi" | 14 | 8 | 14 | 100 | 20 | 6 | 20 | 100 | 34 | 14 | 34 | 100 | 5070 | 4584 | 12.53 | 157 | 4.36 |
| 6 | "Nazmi Osmani" | 10 | 8 | 10 | 100 | 16 | 7 | 16 | 100 | 26 | 15 | 26 | 100 | 2790 | 2604 | 9.52 | 64 | 2.46 |
| 7 | "Ali Asllani" | 9 | 6 | 9 | 100 | 15 | 3 | 15 | 100 | 24 | 9 | 24 | 100 | 3205 | 3047 | 10.11 | 36 | 1.2 |
| 8 | "7 Shtatori" | 6 | 2 | 6 | 100 | 16 | 9 | 16 | 100 | 22 | 11 | 22 | 100 | 2631 | 356 | 9.7 | 16 | 0.7 |
| 9 | "G.Luma" | 6 | 4 | 6 | 100 | 9 | 3 | 9 | 100 | 15 | 7 | 15 | 100 | 960 | 830 | 7.11 | 14 | 0.93 |
| 10 | "A.B." | 5 | 3 | 5 | 100 | 12 | 2 | 12 | 100 | 17 | 5 | 17 | 100 | 1549 | 1222 | 9.38 | 67 | 3.94 |
| 11 | "Dituria" | 8 | 3 | 7 | 88 | 15 | 3 | 14 | 93 | 23 | 6 | 21 | 91.3 | 922 | 179 | 7.36 | 45 | 2.14 |
| 12 | "Naim Frashëri" | 3 | 0 | 3 | 100 | 9 | 1 | 9 | 100 | 12 | 1 | 12 | 100 | 27 | 90 | 5.18 | 0 | 0 |
| | Gjithsej | 149 | 98 | 148 | 99.32 | 207 | 75 | 206 | 99.51 | 356 | 173 | 355 | 99.71 | 51691 | 40912 | 12.26 | 905 | 2.54 |

## 8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

Edukimit dhe arsimimit në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML) i është kushtuar rëndësi e veçantë dhe përkujdesje e merituar, nga se pikërisht në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

Edhe në këtë nivel arsimor, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijes e njëkohësisht edhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësive, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integrimit më të lehtë të tyre në shoqëri.

**8.1 Numri i nxënësve**

Në vitin shkollor 2021-2022 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 1022 (546 mashkuj dhe 476 femra) prej tyre 623 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 399 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar këtë vit shkollor 2021-2022 ( 1022) me atë të vitit të kaluar, atëherë del se sivjet në të dy shkollat e mesme janë regjistruar 136 nxënës më pak, krahasuar me vitin shkollor 2020 - 2021 që ishin të regjistruar gjithsej 1158 nxënës në dy shkollat.
Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" këtë vit mësimor kanë funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore me 4 paralele dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore me 5 paralele, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" kanë funksionuar 4 Drejtime me gjithsej 10 paralele: 1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrikë me nga 1 paralele, 2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet dhe Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele 3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes klimatizimit ujësjellësit e kanalizimit me 2 paralele dhe Trafik rrugor e Automekanik me nga 1 paralele dhe 4. Juridik me profilin; Asistent Juridik me 1 paralele.

**8.2 Suksesi i nxënësve**

Nga numri i përgjithshëm prej 1022 nxënës (476 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 975 nxënës, prej tyre 469 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 479 ose 49.1 %.
Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 492 nxënës ose 50.9 % prej tyre dhe të panotuar e të çregjistruar kanë mbetur gjithsej 51.
Suksesi i arritur reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Periudhë të Parë të vitit shkollor 2021-2022, ndërkaq nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.02 dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.56 dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.48.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6**

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2021-2022

| Emri i shkollës | klasa | Të regjistruar | | Vijojnë | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | % | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TË PA NOTUAR | | | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | shkëlq. | | sh.mirë | | mirë | | mjaft. | | Gjith pozitiv | | | 1X1 | | 1X2 | | Përsërisin me 3x1 | | Gjithsej negativ | | Nuk vijojnë | | Të çregjistr | | |
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | % | Gj | F | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| Gj "Skënderbeu" | X | 236 | 157 | 230 | 154 | 51 | 41 | 49 | 35 | 16 | 12 | 0 | 0 | 116 | 88 | 50.4 | 38 | 24 | 26 | 16 | 50 | 26 | 114 | 66 | 6 | 3 | 0 | 0 | 3.48 |
| | XI | 175 | 103 | 174 | 102 | 43 | 28 | 33 | 19 | 13 | 5 | 0 | 0 | 89 | 52 | 51.2 | 27 | 18 | 19 | 12 | 39 | 20 | 85 | 50 | 1 | 1 | 0 | 0 | 3.58 |
| | XII | 212 | 130 | 209 | 130 | 59 | 42 | 54 | 41 | 14 | 9 | 0 | 0 | 127 | 92 | 66.8 | 16 | 15 | 16 | 10 | 50 | 13 | 82 | 38 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3.6 |
| | X-XII | 623 | 390 | 613 | 386 | 153 | 111 | 136 | 95 | 43 | 26 | 0 | 0 | 332 | 232 | 54.2 | 81 | 57 | 61 | 38 | 139 | 59 | 281 | 154 | 10 | 4 | 0 | 0 | 3.56 |
| ShM Profesionale | X | 142 | 27 | 118 | 26 | 2 | 1 | 3 | 0 | 30 | 9 | 7 | 4 | 42 | 14 | 35.6 | 17 | 3 | 12 | 1 | 44 | 8 | 73 | 12 | 24 | 1 | 3 | 0 | 2.39 |
| | XI | 142 | 35 | 134 | 34 | 4 | 2 | 13 | 6 | 28 | 10 | 10 | 5 | 55 | 23 | 41 | 34 | 7 | 22 | 2 | 23 | 2 | 79 | 11 | 8 | 1 | 0 | 0 | 2.62 |
| | XII | 115 | 24 | 110 | 23 | 3 | 1 | 9 | 1 | 23 | 9 | 15 | 6 | 50 | 17 | 45.5 | 24 | 4 | 20 | 1 | 15 | 1 | 59 | 6 | 5 | 1 | 1 | 0 | 2.44 |
| | X-XII | 399 | 86 | 362 | 83 | 9 | 4 | 25 | 7 | 81 | 28 | 32 | 15 | 147 | 54 | 40.6 | 75 | 14 | 54 | 4 | 82 | 11 | 211 | 29 | 37 | 3 | 4 | 0 | 2.48 |
| Gjithsej | | 1022 | 476 | 975 | 469 | 162 | 115 | 161 | 102 | 124 | 54 | 32 | 15 | 479 | 286 | 49.1 | 156 | 71 | 115 | 42 | 221 | 70 | 492 | 183 | 47 | 7 | 4 | 0 | 3.02 |

## 9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Vijimi rregullt i nxënësve është faktor shumë i rëndësishëm në procesin mësimor që ka synim nxënien e diturive të reja. Në fund të kësaj periudhe nxënësit e nivelit të AML-së kanë bërë gjithsejt 26,941 mungesa (14,474 nxënësit e Gjimnazit dhe 12,467 ata të SHMP) prej të cilave me arsye 17963 ose 27,63 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit dhe arsimtarët është relativisht i lartë, ndërsa shumica prej tyre janë shkaktuar si pasojë e gripit sezonal që nuk i ka kursyer as nxënësit e mësimdhënësit e shkollave tona. Ndërkohë që

DA kërkon nga shkollat përkatëse të ndërmarrin masat e duhura me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Po ashtu, mësimdhënësit e nivelitë AML-së kanë humbur gjithsej 496 orë mësimi apo 5.06 orë mësimi për një arsimtar.
Kualifikueshmëria dhe ngritja profesionale është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e nxënie të suksesshme, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 98 mësimdhënës (97 të kualifikuar ose 98.97 %) prej tyre 43 në Gjimnazin "Skënderbeu" me shkallë të kualifikueshmërisë 97.67 % dhe 55 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" të cilët rezultojnë të gjithë të kualifikuar (100%).

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7**

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat e Mesme të Larta

Tabela Nr. 7

| Nr. | Emri i shkollës | KUADRI ARSIMOR | | | | MUNGESAT E NXËNËSVE | | Mesatarja për nxënës | Orët e humbura të arsimtarëve | Mesatarja për arsimtarë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gj | F | KV | % | Gj | ARSYESHME | | | |
| 1 | "Skënderbeu" | 43 | 22 | 42 | 97.67 | 14474 | 10236 | 23.6 | 232 | 5.4 |
| 2 | SHMP | 55 | 18 | 55 | 100 | 12467 | 7727 | 34.43 | 264 | 4.8 |
| | Gjithsej | 98 | 40 | 97 | 98.97 | 26941 | 17963 | 27.63 | 496 | 5.06 |

Drejtori i Drejtorisë
Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * REPUBLIKA KOSOVA * OPŠTINA KAČANIK